



Duke u bazuar në nenin 11, 12 paragrafi 12.2 shkronjën d), neni 14 paragrafi 1, nenin 17 shkronjën s). Neni 40. Paragrafi 40.2 shkronjën l) dhe neni 58 shkronja a), b), d), g), i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040. Neni 10 pikën 4) dhe 11 të Statutit të Komunës së Klinës, si dhe në bazë të nenit 5, 6, 7, dhe 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim pronën e paluajtshme të komunës. Neni 6 të Rregullores (QRK)– Nr.09/2020, me kërkesën e Drejtorisë Për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi 07.12.2022 të datës nr. prot.01-06-41173/22, me kërkesën e kryetarit të komunës si dhe me rekomandimin e Komitetit për Politik dhe Financa të datës 08.12.2022. Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e XI-të të rregullt për vitin 2022 të mbajtur me 20.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Për miratimin e listës së veçant të pronave të paluajtshme të komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronësi për miratim paraprak të listës së veçant të pronave të paluajtshme të komunës të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023
2. Qellimi i miratimit të listës së veçant të pronave është dhënia në shfrytëzim për interes publik dhe zhvillimin ekonomik të Komunës së Klinës.
3. Pjesë përbërse e këtij vendimi është lista e veçant e pronave komunale që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023, procedurat tjera do të zhvillohen konform Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe rregullorës (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e proceduarve të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.
4. Kjo list e pronave të cilat parashikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2023 do të vlej deri me datë: 31.12.2023
5. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, dhe pas publikimit në Web faqe zyrtare të Komunës.
6. Me këtë vendim njoftohen: MAPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë, Arkivi i Komunës së Klinës dhe Zyra për Informim.

KUVENDI I KOMUNËS SË KLINËS

01Nr. 06-42826 /22
Klinë me 23.12 /22



Kryesuesi,
Fadi Gashi